



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241963

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05609426

**AC-I-23-0029**

**Në ankesën e**

**Paditësja**

**Sh G**, të cilën e përfaqëson avokati B I, Prishtinë.

*kundër*

**E paditura/Ankuesja**

**NSH, "Magjistrala"**, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolejji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1785 të datës 22 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-15-1785 i datës 22 dhjetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Reathanat procedurale dhe faktike**

Me 10 korrik 2013, paditësja, ish punëtore i NSH-së "Magjistrala" në Prishtinë e ka dorëzuar një ankesë të përbashkët me ankuesit tjerë, që të gjithë të përfaqësuar nga avokati B I kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Magjistrala" në Prishtinë PRN032-0054 të datës 31 maj 2013 me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim e pagave të papaguara për periudhën janar 2006 – prill 2007, në shumën totale prej 6,215.36 euro nga NSH- "Magjistrala" në Prishtinë. Kjo ankesë e përbashkët në bazë të urdhrin të gjykatës është ndarë, andaj avokati i paditëses me datë 30 shtator 2015, e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe bënë ndarjen dhe plotësimin e ankesës, e cila regjistrohet me numrin C-IV.-15-1785. Paditësja në ankesë pohon se në NSH "Magjistrala" në Prishtinë ishte në marrëdhënie të përhershme pune dhe kishe dokumentacion të mjaftueshëm, që asaj t'i paguhen pagat e pa paguara deri në ditën e privatizimit të NSH-së. Paditësja, konsideron se e paditura nuk e ka kontestuar faktin se paditësja ishte në marrëdhënie pune të rregullt dhe të përhershme në NSH "Magjistrala". Për këtë ekziston dokumentacioni i mjaftueshëm, mirëpo përkundër kësaj është refuzuar kërkesa për pagesat e pagave, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar si dhe ka kërkuara kamatën ligjore si dhe shpenzimet e përfaqësimit.

Me 14 shkurt 2020, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit që ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja në mbrojtje në ankesë ka pohuar se ankesa e paditëses është e papranueshme pasi që është e pa afatshme nëse merret në konsideratë se paditësi ankesën e ka paraqitur me datë 30 shtator 2015. Prandaj parashtresa për rregullimin e padisë e datës 30 shtator 2015 është dorëzuar më tepër se dy vjet pas kalimit të aftit dhe si e tillë është e pa pranueshme dhe pa asnjë vlerë ligjore. Tutje AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit duke i përmbushur përgjegjësitë e veta ligjore, ka kërkuar së pari prej paditëses e pastaj edhe prej burimeve të tjera, prova për përcaktimin e të drejtës në kompensimin e pagave të pa paguara, ndërsa Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se një grup i ish punëtorëve të NSH-së kanë kryer punë të caktuara për të cilat janë paguar, ndërsa paditësja

nuk ka qenë në listën e pagave, andaj ajo nuk ka punuar në NSH-ë. Tutje AKP-ja pohon se do të ishte padrejtësi që të paguhen ish punëtorët me grupin e punëtorëve që kanë punuar në NSH. AKP-ja po ashtu pohon se paditësi kishte për detyrë ta provojë me prova kërkesën e sajë pastaj duke mbledhur provat e nevojshme për sqarimin e situatës dhe gjetjen e së vërtetës mbi të drejtën e ankuesit për kompensimin e kërkuar. Mirëpo Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se dokumentacioni i ofruar nuk ishte i plotë, andaj ka vendosur ta refuzojë kërkesën. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Me 03 qershor 2021, Shkalla e I-rë me shënim zyrtar nga lënda fillestare C-IV.-13-1216 ka tërhequr provat që janë bashkangjitur për këtë ankuese/ankesë dhe atë dokumentnë kopje si në vijim: autorizimin për përfaqësim, vendimin e kundërshtuar, letërnjoftimin dhe librezën e punës.

Me 23 maj 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS lëshon një Urdhër për paditësen dhe kërkon nga ajo që të dorëzojë prova shtesë në mbështetje të ankesës se saj.

Me 03 qershor 2022, përfaqësuesi i ankuesit i është përgjigjur urdhrin të gjykatës dhe ka dorëzuar si provë: njoftimin e datës 22 maj 2007, librezën e punës, një përmbledhje mujore të pagave të punëtorëve të NSH-së për periudhën janar 2005 –prill 2007, shkresën e NSH drejtuar AKP në lidhje me prezantimin e listave të punëtorëve, deklaratën e përbashkët të noterizuar të dhënë nën betim të ish drejtorit Sh P dhe llogaritarit A K dhe letërnjoftimet e tyre, kontratën e punës të ish drejtorit Sh P, aktvendimin nr.1088, datë 21 qershor 2007 (për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësit sipas njoftimit të AKM-së të datës 22 maj 2007), referencën nr.22 të datës 16 korrik 2007 të lëshuar nga NSH për ish drejtorin Sh P dhe regjistrin e punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjate punës në NSH.

Me 12 korrik 2022, e paditura në përgjigjen e saj ndaj urdhrin të gjykatës, ka pohuara se ankuesja nuk ka bashkangjitur ndonjë argument të ri në mbështetje të pretendimeve të saj të cilat nuk janë trajtuar më herët. I ka propozuar Gjykatës që ta refuzoj si te pa bazuar ankesën dhe parashtresën e saj të plotësuar si dhe ta vërtetoj vendimin e AL.

Më 22 dhjetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së me Aktgjykimin C-IV.-15-1785 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesa e paditëses, ka ndryshuar vendimi i AL të AKP-së PRN032-0054 të datës 31 maj 2013 dhe e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoj pagat e pa paguara për periudhën janar – 2006- prill 2007 , t'i paguajë në shumën neto prej 5,116.19 euro, në emër të interesit ligjor prej 10%, të shumës themelore, ti paguaj shumen prej 511.61 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar ishte refuzuar si e pabazuar. Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Gjithashtu paditëses ia ka njohur edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00 euro. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se ankesa e paditëses ishte e afatshme pasi që përfaqësuesi i ankueses kishte dorëzuar ankesën grupore me 03 korrik 2013, pra brenda afatit prej 30 ditëve. Tutje shkalla e parë ka arsyetuar se nga librezat e punës e dorëzuara si provë, vërtetohet fakti se paditësja kishte krijuar marrëdhënie punë në NSH "Magjistranja" nga data 09 prill 1975 deri me 13 prill 2007, kohë edhe kur edhe kishte filluar likuidimi i NSH duke shtuar se një fakti tillë vërtetohet edhe nga regjistri i punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjatë punës në NSH. Nga përmbledhja e mujore e pagave të punëtorëve të NSH "Magjistranja" të nënshkruara nga llogaritari dhe drejtori i NSH, gjykata e kishte vërtetuar se paditësja kishte paga mujore neto në lartësi prej 319.33 euro, ku gjithsejtë paditësja për periudhën nga janari 2006 – prill 2007 kishte paga në lartësi prej 5,116.19 euro. Nga deklarata nën betim të noterizuar, ish drejtori në NSH Sh P dhe llogaritari A K kanë deklaruar se me përgjegjësi të plotë morale, penale dhe materiale sa i përket çështjes së listës së pagave të nënshkruara tek NSH kanë qenë kompetent për të nënshkruar dhe janë të gatshëm të dëshmon në çdo kohë se këto lista të pagave paraqesin gjendjen e saktë të detyrimeve. Po ashtu Shkalla e I-rë ka arsyetuar se nga njoftimi i datë 22 maj 2007 vërtetohet fakti se ankuesja ishte njoftuar se asaj i kishte përfunduar marrëdhënia e punës në NSH, dhe se pagat e mbetura borxh do të realizohen tek procedura e likuidimit. Shkalla e I-rë kishte pranuar si prova relevante dhe të bazuara regjistrin e punëtorëve të NSH-së, njoftimin e datë 22 maj 2007 dhe përmbledhjen mujore të rrogave për periudhën janar 2006 –prill tetor 2007 për të arritur në përfundim se ankuesja kishte ofruar shërbime pune në NSH për periudhën e lartë cekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. Po ashtu kishte arsyetuar se e paditura nuk

ka mundur të dëshmoje se paditëses i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës para periudhës për të cilën ishte parashtruar kërkesa apo se nuk i ka mbetur borxh paga. Në rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 5,116.19 euro Shkalla e I-rë është bazuar në përmbledhjet mujore të pagave për periudhën janar 2006 –prill 2007, ashtu që për muajt janar- dhjetor 2006 janë njohur paditësit pagat e pa paguara ne shumë 3,831.96 euro. Dhe për muajt janar –prill 2007 i janë njohur pagat në shumën prej 1,284.23 euro. Gjithsejte paditëses i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 5,116.19 euro. Kërkesa tjetër përtej shumës së kërkuar e që figuron në përmbledhjen mujore të rrogave e qe është 1,099.17 euro, nuk është e mbështetur me provat e nevojshme materiale, prandaj si e tille eshet refuzuar si e pabazuar.

Me 18 janar 2023, e paditura dorëzoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-1785, të datës 22 dhjetor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë ta refuzoj ankesën e paditësit të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe ta vërtetoj vendimin e AL. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se me Aktgjykimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. AKP-ja pohon se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes nuk ka marr parasysh faktin se paditësja nuk ka qenë në Listën e pagave për periudhën e cekur janar 2006 – prill 2007. Në lidhje me këtë konstatim, autoriteti i likuidimit thekson se Gjykata ka ngatërruar çështje të rëndësishme faktike e rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasojë ka bere vlerësim të gabuar dhe ka marrë aktgjykim të pa drejtë. Pasi që parashtruesja nuk ka arritur te siguroje dokumentacionet dhe dëshmitë e nevojshme për aprovimin e kërkesës së saj. Autoriteti i likuidimit për të kryer verifikime të mëtejshme për aprovimin e kërkesës se tij ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike mbi historikun e llogarisë se klientes, nga te cilat ka rezultuar se parashtruesja e kërkesës nuk figuron në liste në pagesat e NSH-së si një e punësuar e saj. Tutje AKP-ja në ankesë pohon se paditësja nuk ka saktësuar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur, duke pohuar se DHPGJS-ja ka kompetencë të shqyrtoi vetëm

ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Më 26 janar 2024, Kolegji i Apelit ankesën e AKP-së e ka dërguar tek paditësi për përgjigje.

Me 12 shkurt 2024, përfaqësuesi i paditëses përmes përgjigjes në ankesë ka kundërshtuar pretendimet ankimore të AKP-së si të pa bazuara meqë Shkalla e I-rë ka administruar dhe nxjerr të gjitha provat e propozuar e të cilat kanë qenë të nevojshme për ti vërtetuar faktet vendimtare. Përfaqësuesi i paditëses i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. Ajo ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i animuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe te detyrohet e paditura që te bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, për hartimin përgjigjes në ankesën e AKP-së ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë në shumën prej 208 euro, sipas nr. Tariforë 9, krahas shpenzimeve të tjera të kërkuara para parashtrimit të kësaj përgjigje në ankesë. Paditësja në ankesën e parashtruar i kundërshton pretendimet ankimore të së paditurës për shkak se me anë të Njoftimit të datës 16 korrik 2007, drejtori i NSH" Magjistrala" duke u përgjigjur në shkresën e AKM-së me nr.19 të datës 10 korrik 2007, ka dorëzuar të gjithë regjistrat e punëtorëve për të gjitha njësitë njësite punuese të kësaj NSH-je. Në baze të këtyre regjistrave janë dhënë sqarime për të gjitha ndalesat në të ardhurat personale si ato të Trustit pensional të Kosovës dhe të cilat janë paguar, e të cilat vetëm të deklaruar e të pa paguara. Pra siç shihet nga dokumenti i dorëzuar si prove në DHPGJS, i cili është noterizuar dhe dëshmon saktë të gjitha listat për periudhat kontestuese i janë dorëzuar të paditurës lidhur me punëtoret aktiv deri në ditën kur punëtoret kanë pranuar njoftimet mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Po ashtu me provat siç janë Listat e Pagave për periudhën kontestuese janë nënshkruar nga personat kompetent, ku shijet se paditësja Sh G është radhitur në numrin 4 dhe është përfshirë në Listën e pagave tek njësia e Drejtorisë, Sipas kësaj liste shihet qartë se paditësja ka qenë punëtores aktive deri në momentin kur e paditura në bazë të njoftimit e ka ndërprere llogarinë e pagave, përpilimin e tyre si dhe nënshkrimin para marrjes së vendimit të shkallës së parë janë bashkangjitur dëshmitë siç janë : Deklarata nën betim të dhënë para noterit

të drejtorit të NSH-së Sh P si dhe Kontabilistit A K, ku në bazë të kësaj deklarate të njëjtit vërtetojnë se në bazë të akteve te brendshme dhe pozitive te tyre kanë qenë kompetent për përpilimin dhe nënshkrimin e këtyre listave. Ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 12 korrik 2007, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Magjistrala" (në likuidim), një kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën janar 2006 deri në prill 2007, në shumë prej 6,215.36 euro, e cila kërkesë ishte refuzuar me arsyetimin se paditësja nuk figuron si e punësuar në NSH-në dhe nuk ka qenë në Listën e pagave.

Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së me Aktgjykimin C-IV.-15-1785 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditëses, ka ndryshuar vendimi i AL të AKP-së PRN032-0054 të datës 31 maj 2013 dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensoj pagat e pa paguara për periudhën janar 2006 –prill 2007, t'i paguajë shumën neto prej 5,116.19 euro, në emër të interesit ligjor prej 10%, të shumës themelore, ti paguaj shumën prej 511.61 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumes së aprovuar ishte refuzuar si e pabazuar. Gjithashtu paditësit ia ka njohur edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00 euro.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së arsyeton se paditësja me dt.22 maj 2007 i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i vendimit të AKM-së për shitjen-privatizimin e NSH-s, gjë e cila vërtetohet me kopjen e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Shkalla e I-rë nga librezja e punës e dorëzuara si provë, ka vërtetuar faktin se paditësja kishte krijuara marrëdhënie punë në NSH "Magjistranja" nga data 09 prill 1975 deri me 13 prill 2007, kohë edhe kur edhe kishte filluar likuidimi i NSH duke shtuar se një fakti tillë vërtetohet edhe nga regjistri i punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjatë punës në NSH.

Kolegji i Apeli vëren se Shkalla e I-rë me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 5,116.19 euro, është bazuar në përmbledhjet mujore të pagave për periudhën janar 2006 –prill 2007, ashtu siç u konstatua me lartë. Kërkesa tjetër përtej shumës së kërkuar e që figuron në përmbledhjen mujore të rrogave nuk është e mbështetur me provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë është refuzuar si e pabazuar. Po ashtu Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë me rastin e vendosje ka vlerësuar edhe deklaratën nën betim të noterizuar, të ish drejtorit në NSH Sh P dhe llogaritarit A K të cilët kanë deklaruar se me përgjegjësi të plotë morale, penale dhe materiale sa i përket çështjes se listës së pagave të nënshkruara tek NSH kanë qenë kompetent për ti nënshkruar dhe janë të gatshëm të dëshmon në çdo kohë se këto lista të pagave paraqesin gjendjen e saktë të detyrimeve.

Duke i vlerësuar provat që paditësja i ka sjellë në Shkallën e I-rë, siq janë: njoftimin e datës 22 maj 2007, librezën e punës, një përmbledhje mujore të pagave të punëtorëve të NSH-së për periudhën janar 2005 –prill 2007, shkresën e NSH drejtuar AKP në lidhje me prezantimin e listave të punëtorëve, deklaratën e përbashkët të noterizuar të dhënë nën betim të ish drejtorit Sh P dhe llogaritarit A K dhe letërnjoftimet e tyre, kontratën e punës të ish drejtorit Sh P, aktvendimin nr.1088, datë 21 qershor 2007 (për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësit sipas njoftimit të AKM-së të datës 22 maj 2007), referencën nr.22 të datës 16 korrik 2007 të lëshuar nga NSH për ish drejtorin Sh P dhe regjistrin e punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjatë punës në NSH, Shkalla e I-rë e me të drejtë e ka aprovuar pjesrisht ankesën e paditëses si të bazuar, dhe e ka ndryshuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.



Kolegji i Apelit vren se përmbledhjet e rrogave mujore nuk janë të protokulluara dhe nuk janë të vulosuar, por pasi që gjendja faktike është vërteuar edhe me librezën e punës, regjistrin e punëtorve dhe të dhënave të tyre gjate punes në NSH si dhe njoftimin e dates 22 maj 2007, gjykata i merr si relevante këto përmbledhje për të përcaktuar shumën që i është njohur paditese.

Kolegji i Apelit i mbështetë të gjeturat faktike dhe konstatimet e Shkallës së I-rë të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar, të cilat i konsideron si të drejta dhe të mbështetura në prova.

Kolegji i Apelit vleron se provat e paraqitura në procedurën e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, janë prova të mjaftuara për njohje të të drejtës së pretenduar në paga, meqë është e qartë se këto prova e vërtetojnë faktin se paditësja ka ofruar shërbime pune për NSH-në, dhe se NSH-ja për punën e kryer është e detyruar që paditëses, ti paguaj pagat e papaguar e të cilat duhet të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja me mbrojtje në ankesë dhe me ankesën e saj në Shkallën e II-të, pretendon se paditëses janë paguara 80 % të pagës se saj neto nga NSH. Këto pretendime lidhur me këto fakte të pohuara nga AKP-ja, nuk janë mbështetur me prova konkrete, prandaj për këtë arsye nuk janë marrë në konsideratë nga ana e Kolegjit të Apelit.

Prandaj nga se u tha më lartë, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **Taksa gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 100 euro me datë 15 shkurt 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_